

TIRANË, 2021

# GUIDA STUDENTORE

(Botimi i tretë)

Mirë se erdhët!

**Studentët dhe UPT kanë menduar për ju këtë vit të ri akademik 2021-2022!**

# Përmbajtja

**Hyrje** \_\_\_\_\_ 4

-Kush jemi ne ? \_\_\_\_\_ .

-Qëllimi i Guidës Studentore \_\_\_\_\_ .

**Kapitulli 1** \_\_\_\_\_ 5

- Njohja me qytetin e Tiranës \_\_\_\_\_ .

**Kapitulli 2** \_\_\_\_\_ 8

*Universiteti im*

- Struktura Organizative Institucionale e UPT-së
- Struktura Organike Drejtuese e Rektoratit të UPT-së
- Strukturat në mbështetje dhe shërbim të studentëve

*Fakultetet përbërëse* ,

2.1 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)

2.2 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)

2.3 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike (FIMIF)

2.4 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave (FGJM)

2.5 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)

2.6 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)

2.7 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)

2.8 Instituti i Gjeoshkencave, Enerjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)

<b>Kapitulli 3</b>	<b>45</b>
- Platformat Online	.
<b>Kapitulli 4</b>	<b>50</b>
- Tarifat e shkollimit cikli i studimeve Bachelor, UPT	.
<b>Kapitulli 5</b>	<b>60</b>
- Të drejtat e mia (bazuar në nenet e Ligjit të Arsimit të Lartë)	.
<b>Kapitulli 6</b>	<b>67</b>
- Qyteti i Studentëve	.
1. Akomodimi	.
2. Procedurat e regjistrimit	.
3. Informacion mbi rezidencat studentore	.
4. Të drejtat dhe detyrat e studentëve në rezidencat studentore	.
<b>Kapitulli 7</b>	<b>73</b>
- Të gjejmë rrugët	.
1. Linjat kryesore të transportit qytetas	.
2. Sistemi i transportit ndërqytetas	.
a.Terminali i autobusëve, zona Jug (linjat dhe oraret)	.
b.Terminali i autobusëve, zona Jug - Lindje (linjat dhe oraret)	.
c.Terminali i autobusëve, zona Veri (linjat dhe oraret)	.
<b>Kapitulli 8</b>	<b>86</b>
- Kontakte të rëndësishme	.
<b>Terminologja e përdorur dhe Bibliografi</b>	<b>89</b>
<b>Përbledhje</b>	<b>90</b>
<b>Falenderime</b>	<b>91</b>

# Hyrja

## Kush jemi ne?

Ne jemi një grup studentësh nga fakultete të ndryshme të Universitetit Politeknik të Tiranës. Në mbështetje të studentëve vendosëm të krijojmë këtë guidë studentore, e cila do t'u vijë në ndihmë veçanërisht atyre studentëve, të cilët fillojnë për herë të parë studimet universitare.

## Qëllimi i Guidës Studentore

Guida Studentore ka për qëllim të shërbejë si një udhërrëfyes për lehtësimin dhe përmirësimin e jetës tuaj studentore.

Kjo guidë do të ketë karakter:

- informues mbi të drejtat dhe detyrimet e studentëve, vendndodhjet, strukturën e brendshme të universitetit të tyre, ndarjen e fakulteteve dhe pikat e kontakteve të rëndësishme;
- orientues mbi njojen e sistemit të transportit urban, qytetas dhe ndërqytetas që ndihmon në lehtësimin e aktivitetit të ngarkuar ditor;
- njoħes mbi tarifat, adresat dhe kontaktet e nevojshme dhe të domosdoshme të çdo institucioni në shërbim të qytetarit dhe më specifikisht në shërbim të studentit;

# KAPITULLI 1

## NJOHJA ME QYTETIN E TIRANËS



Shumë aktivitete dhe përfshirje në komunitet do ju jepin një trajnim që do ju zhvillojë në mënyrë të paçmuar më vonë në jetë, këtë e mundëson qyteti ynë.

Tirana është kryeqendra e qarkut dhe rrethit me të njëtin emër dhe kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Është qyteti më i madh i Shqipërisë dhe njëkohësisht qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, industriale, mediale, akademike, sociale dhe kulturore e vendit.

Qyteti i Tiranës është ndarë në njëmbëdhjetë njësi administrative të vogla.



Figura 1.1 – Ndarja administrative e qytetit të Tiranës

**Sa shumë gjëra për të bërë në Tiranë!**

**Këtu do të gjeni 10 prej tyre:**

- Shijo pamjet më të bukura të Tiranës nga mali i Dajtit;
- Shijoni harmonizimin e monumenteve kulturore në sheshin “Skënderbej”;
- Ndalesë në Piramidën e Tiranës;
- Relaksohuni në Kopshtin Botanik;
- Shijoni aktivitetet çlodhëse në Liqenin Artificial të Farkës;
- Mësoni sekrete nga muzeu “Shtëpia e Gjethive”;
- Zbuloni historinë e monedhës Shqiptare në Muzeun e Bankës së Shqipërisë;
- Vizitonit Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura;
- Kaloni një pasdite të këndshme në Kalanë e Tiranës;
- Foto para instalacionit I LOVE TIRANA;



## KAPITULLI 2


UNIVERSITETI IM

Në këtë kapitull do t'ju prezantojmë me një informacion të përgjithshëm për Universitetin Politeknik të Tiranës dhe më pas do të ndalemi në vendndodhjen, fakultetet përbërëse dhe strukturën organizative të universitetit.

Qëllimi i këtij kapitulli është që studentët jo vetëm të informohen dhe të jenë pjesë e jetës studentore në fakultetet ku janë të regjistruar, por të kenë gjithashtu edhe një pasqyrë të universitetit në përgjithësi.

Në vazhdim do të ndalemi në pikat e lartpërmendura.

Arsimi është pasaporta jonë  
për të ardhmen, sepse e nesërmja  
u përket njerëzve që përgatiten  
për të, Sot.



## UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Universiteti Politeknik i Tiranës ka njojur një ndryshim të vazhdueshëm që nga krijimi i tij e deri më sot gjithmonë duke kërkuar t'i përshtatet kërkesave, zhvillimit të shoqërisë dhe kulturës shqiptare.

Traditat e këtij Universiteti fillojnë që në vitin 1951, me ngritjen e Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë, i cili përbante disa degë kryesore inxhinierike:

- Degën e Inxhinierisë Mekanike
- Degën e Inxhinierisë Elektrike
- Degën e Inxhinierisë së Ndërtimit



Stafi i tij akademik përbëhej fillimisht nga pedagogë rusë dhe asistentë shqiptarë, të diplomuar në fakultetet inxhinierike, kryesisht të vendeve të Europës Lindore, të cilët më pas me rritjen e nivelit të kualifikimit dhe të specializimit bënë të mundur zëvendësimin e plotë të pedagogëve të huaj me pedagogë shqiptarë.

Në **1957**, si pjesë përbërëse e Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë përfshinte:

- Dega Mekanike
- Dega Elektrike
- Dega e Ndërtimit
- Dega e Gjeologji-Minierave, në të cilat diplomoheshin inxhinierë të përgjithshëm sipas katër fushave përkatëse inxhinierike

Në vitin 1971 përfundoi ristrukturimi i parë i programeve të studimit si dhe në këte periudhë u bë i mundur kualifikimi i stafit akademik jashtë vendit duke sjellë rezultate të shkëlqyera dhe përmësimdhënien dhe kërkimin shkencor në universitet.

Formimi i Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) duke u shkëputur nga Universiteti i Tiranës, në vitin 1991 bëri të mundur krijimin e katër fakulteteve:

- Inxhinierisë Mekanike (FIM);
- Inxhinierisë Elektrike (FIE);
- Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN);
- Fakultetit të Gjeologji-Minierave (FGJM);

Në këtë kuadër u ndërtuan programe të reja studimi dhe u rrit numri i drejtimeve të tyre. Në vitin 1994 struktura organizative e fakulteteve të UPT-së ndryshoi: u krijuan departamentet, të cilët u detajuan deri në seksione.



Vëmendje të veçantë UPT i ka kushtuar lidhjes, komunikimit dhe bashkëpunimit si me partnerët brenda vendit ashtu dhe me partnerët homologë jashtë vendit. Përmendim bashkëpunime të frutshme të UPT-së, veçanërisht në fushën e mësimdhënies, me universitetetë tilla si Politekniku i Barit (Itali), Politekniku i Torinos (Itali), Instituti Politeknik i Athinës, Universiteti i Sigenit (Gjermani), Bergakademie Freiberg (Gjermani), Universiteti i Metz (Francë), Institut i Lartë i Materialeve dhe i Konstruksioneve Mekanike (Francë), Universiteti i Dublinit (Irlandë), etj.

Viti 2005 shënoi ristrukturimin e programeve të studimit të UPT, bazuar në “**Deklaratën e Bolonjës**”. Këtë vit filloi implementimi i programeve të studimit në dy cikle: në ciklin 3 vjeçar (Bachelor) dhe në ciklin pasues 2 vjeçar (Master, të ndarë në: Master Profesional dhe Master Shkencor). Ndërsa në vitin 2009 filloi implementimi i programeve të studimit të ciklit të tretë 3 vjeçar (Doktorata).

Viti 2007 e gjen UPT me gjashtë fakultete, përveç katër fakulteteve ekzistues krijuhen:

- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)
- Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF).

Në vitin 2011, në bazë të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 9741, Dt. 21.05.2007, pranë UPT u vendosën dy institute:

- Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM)
- Instituti i Gjeo-Shkencës (INGJSH), të cilët, u bashkuan duke krijuar “**Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)**”.

Në vitin 2013 krijohet fakulteti i shtatë, ai i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU), duke u veçuar nga Fakulteti i Ndërtimit.

Aktualisht, Universiteti Politeknik i Tiranës është i vetmi universitet inxhinierik në Shqipëri, me një histori përpjekjesh pune, arritjesh dhe suksesesh 70 vjeçare në përmbushje të sfidave prioritare që lidhen me rritjen e nivelit cilësor në të gjitha aktivitetet qe dikton realizimi i misionit të tij historik.

### ***Programet e studimit***

Universiteti Politeknik i Tiranës zbaton programin e kartës së Bolonjës (3+2). Ofrohen studime të ciklit të parë Bachelor, të ciklit të dytë Master Shkencor dhe Profesional si dhe Master Shkencor 5 vjeçar (DIND). UPT ofron gjithashtu studime të ciklit të tretë - Doktoratura - në të gjitha fakultetet përbërëse të saj.

## **1. Struktura Organizative Institucionale e UPT-së**

### **Senati Akademik**

Senati Akademik është organ kolegjial vendimmarrës i zgjedhur në nivel universiteti. Veprimtaria e Senatit të UPT, mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Senati është organi më i lartë i universitetit që përcakton politikat e zhvillimit të tij, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor, problemet administrativo-financiare si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Senati akademik kryesohet nga Rektori, i cili është kryetar i tij dhe përbëhet nga 37 anëtarë të brendshëm, të zgjedhur, si përfaqësues të grupimeve përkatëse të universitetit sipas nenit 9, pika

4, të statutit të UPT, + 1 (Rektori) që le detyrën në zgjedhjet e radhës. Ndër to 4 anëtarë janë studentë të zgjedhur unanimisht nga studentët e UPT.

### **Bordi i Administrimit**

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përm bushjen e misionit të Universitetit Politeknik të Tiranës, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Rektori dhe Administratori i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky bord.

Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë:

- a- Përfaqësues të zgjedhur nga UPT (3 anëtarë)
- b- Të emëruar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përfaqësues nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike (4 anëtarë)

### **Struktura Drejtuese e Rektoratit të UPT-së**


Rektor: Prof. Dr. Andrea Maliqari

Administrator: Besmir Ali

Zv. Rektor për anën Shkencore: Prof. Asoc. Elfrida Shehu

Zv. Rektor për anën Mësimore: Prof. Asoc. Akli Fundo

## Organigrama e Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës




## Strukturat në mbështetje dhe shërbim të studenteve

### Zyra e Këshillimit të Karrierës

Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron një gamë të gjerë shërbimesh për studentët dhe të diplomuarit e UPT, të cilat kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Shërbimet kryesore që Zyra e Këshillimit të Karrierës ofron janë:

- Identifikimi dhe informimi mbi oportunitetet edukative (bursa, trajnime, etj.),
- Këshillim karriere nëpërmjet vlerësimit të interesave, vlerave dhe aftësive profesionale,
- Trainime/workshop-e për zhvillimin e aftësive që mund të rrisin mundësitet e futjes së të diplomuarve në tregun e punës,
- Informimi dhe promovimi i ofertave të internshipeve, vendeve të punës, etj.,
- Këshillimi i studentëve të UPT që diplomohen në Ciklin e Parë për mundësitet e studimeve në Ciklin e Dytë në UPT ose universitete të tjera jashtë vendit,
- Mbajtja e kontaktit me alumnët dhe ndërthurja e kërkesave dhe ofertave të edukimit gjatë gjithë jetës,
- Lidhja e vazhdueshme dhe aktive me kompanitë brenda dhe jashtë vendit si dhe vlerësimi/analiza e kërkesave të tyre për forcë pune,
- Aktivitete të ndryshme promovuese dhe informuese ndër të cilat rëndësi të veçantë zë organizimi i përvitshëm i Panairit të Punës,
- Informimi i maturantëve, studentëve të ardhshëm për programet e studimit, kriteret e pranimit dhe politikat e UPT.
- Zyra e Këshillimit të Karrierës është e pozicionuar në Rektoratin e UPT-së, në Korpusin Qendror, kati i parë, adresa e-mail: [zyraekarrieres@upt.al](mailto:zyraekarrieres@upt.al)



## Kërkimi Shkencor dhe Projektet

Kërkimi Shkencor dhe Projektet mbulojnë gjithë bashkëpunimet me universitetet e huaja, zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me to, aktivitetet në kuadrin e Rrjeteve Universitare Ballkanike, Evropiane dhe më gjerë, zbatimin e projekteve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë institucioni, në përputhje me ligjet e Shtetit Shqiptar.

### **Projektet Erasmus +**

Në kuadër të programit të Erasmus+ promovohen mobilitetet e studentëve dhe të stafit akademik në universitetet homologe në Europë e më tej bazuar në marrëveshjet ndërinstitucionale. Në mobilitete janë përfshirë një numër i konsiderueshëm studentësh të cilët kanë patur eksperiencia shumë pozitive dhe të frytshme me ndikim pozitiv dhe me vlera të shtuara në formimin e tyre. Studentët informohen nëpërmjet faqes zyrtare të universitetit [www.upt.al](http://www.upt.al)

### **Sekretaria Mësimore**

Sekretaria mësimore është një nga strukturat më të rëndësishme që gjendet brenda çdo fakulteti të UPT. Sekretaria mësimore është një strukturë racionale e krijuar për të përbushur sa më mirë detyrat e organizimit të procesit mësimor të fakultetit, në shërbim të studentëve dhe të stafit akademik.

Personeli i sekretarisë mësimore punon me ndjenjë të lartë përgjegjshmërie për të zbatuar Statutin e UPT, Rregulloren e UPT në procesin e mësimdhënies në gjithë aktivitetet e fakultetit, për të patur rezultate të larta në punë, si dhe u shërben me përkushtim studentëve dhe stafit akademik.

Sekretaria mësimore ka në principin e saj zbatimin e ligjshmërise dhe punon për mbarëvajtjen e gjithë aktivitetit mësimor të fakultetit. Kjo strukturë është përgjegjëse për korrektësinë e plotësimit dhe mbajtjes së dokumentacionit, si dhe të informimit të studentëve dhe stafit akademik.

Pranë sekretarive mësimore bëhet regjistrimi i studentëve të vitit të parë në regjistrin themeltar në bazë të listës së fituesve si dhe regjistrimi i studentëve të viteve të tjera. Këtu studentët mund të marrin shërbim për plotësimin e vërtetimeve të ndryshme, librezat e notave, kartat e studentit si dhe dublikatat e tyre kur është e nevojshme, etj.

**Fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës:**

**1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)**



## Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)

### Pak histori

Studimet për arkitekturë për herë të parë filluan në vitin 1969 dhe në 1983 dega e Arkitekturës u bë pjesë e fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në kuadër të Universitetit të Tiranës. Në 1993 u krijuar Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës i cili funksionoi deri në 2013, vit i cili shënoi krijimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës



### Struktura e brendshme organizative

Dekan FAU	<b>Prof. Asoc. Armand Vokshi</b>
Zv. Dekan	<b>Dr. Loreta Çapeli</b>
Zv. Dekan	<b>MSc. Ani Panariti</b>



Nr.	Programi i studimit	Lloji i diplomës
1.	Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	Bachelor
2.	Arkitekturë profil Arkitekt	Master i shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt
3.	Arkitekturë profil Urbanist	Master i shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist
4.	Restaurim i Monumenteve të Kulturës	Master profesional
5.	Arkitekturë	Doktoraturë (PHD)
6.	Urbanistikë	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:**

Rr. "Muhamed Gjollesha", 54, Tiranë, pranë kryqëzimit të "21 Dhjetorit"

Për më shumë informacione: <https://fau.edu.al/>

Zyra e Karrierës: [zeqiraj.marsilda@hotmail.com](mailto:zeqiraj.marsilda@hotmail.com)


## 2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)



## Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)


### Pak histori

FIN është një nga fakultetet më të vjetra dhe më me eksperiencë në arsimin e lartë shqiptar. Ai është themeluar më 1951 si Degë Ndërtim në kuadër të Institutit të Lartë Politeknik të Tiranës dhe më vonë është bërë pjesë e Universitetit të Tiranës. Në vitin 1983 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit u krijuai si njësi më vete në përbërje të UT dhe më pas e UPT-së.



### Struktura e brendshme organizative

Dekan FIN	<b>Prof. Asoc. Neritan Shkodrani</b>
Zv.Dekan	<b>Dr. Markel Baballëku</b>
Zv.Dekan	<b>Dr. Konalsi Gjoka</b>



Nr.	Programi i studimit	Lloji i diplomës
1.	Inxhinieri Ndërtimi	Bachelor
2.	Inxhinieri Hidroteknike	Bachelor
3.	Inxhinieri Mjedis	Bachelor
4.	Inxhinieri Gjeodezi	Bachelor
5.	Inxhinieri Ndërtimi. Profili Ndërtim dhe Administrim	Master Shkencor
6.	Inxhinieri Ndërtimi, Profili Strukturist	Master Shkencor
7.	Inxhinieri Ndërtimi, Profili Infrastrukturë e Transportit	Master Shkencor
8.	Inxhinieri Ndërtimi, Profili Gjeoteknikë	Master Shkencor
9.	Inxhinieri Hidroteknike	Master Shkencor
10.	Inxhinieri Mjedis, Profili Trajtim Ujërash	Master Shkencor
11.	Inxhinieri Mjedis, Profili Energjitikë	Master Shkencor
12.	Inxhinieri Gjeodezi	Master Shkencor
13.	Diplomë e Dyfishtë në Inxhinieri Ndërtimi në partneritet me Ecole Speciale des Travaux Publics, Paris, FRANCE	Master Shkencor
14.	Inxhinieri Hidroteknike	Master Profesional
15.	Inxhinieri Mjedis	Master Profesional
16.	Inxhinieri Gjeodezi	Master Profesional
17.	Inxhinieri Ndërtimi	Doktoraturë (PHD)
18.	Inxhinieri Gjeodezi	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:** Rr. "Muhamet Gjollesha", 54, Tiranë, pranë kryqëzimit të "21 Dhjetori".





Figura 2.1 – Vendndodhja e FIN & FAU

Për më shumë informacione: [fin.edu.al](http://fin.edu.al)

Zyra e Karrierës: [caushi\\_irena@yahoo.com](mailto:caushi_irena@yahoo.com)

Këtë vit akademik studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit do të zhvillojnë mësim në godinat e fakulteteve të tjera të UPT për shkak të rikonstruktimit të godinës së fakultetit.

### 3. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike (FIMIF)




## Fakulteti i Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike (FIMIF)

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike u krijuat si pjesë përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës në vitin 2007. Ky është një fakultet i cili ofron formim bazë dhe të avancuar të shkencave inxhinierike si dhe të shkencave kompjuterike, fotonike, elektronike, optike, automatizim dhe telekomunikacion. Studentët të cilët diplomohen pranë FIMIF punësohen në shumë fusha të ekonomisë ndër të cilat mund të përmendim: inxhinierë në laboratorët e kontrollit dhe të testimtëve të materialeve; inxhinierë për aplikimin e metodave moderne të matjes së rrezatimeve optike, të temperaturës, emisioneve akustike, përdorimit të ultratingujve për qëllime industriale dhe mjekësore; inxhinierë për përdorimin e pajisjeve lazer dhe me fibra optike në teknologjinë e komunikimit etj.

### Struktura e brendshme organizative

Dekan FIMIF	<b>Prof. Shkëlqim Kuka</b>
Zv. Dekan	<b>Prof. Asoc. Valbona Muda</b>
Zv. Dekan	<b>Prof. Asoc. Dhurata Kuqi</b>



Nr.	Programi i studimit	Lloji i diplomës
1.	Inxhinieri Fizike	Bachelor
2.	Inxhinieri Matematike	Bachelor
3.	Inxhinieri Fizike	Master Profesional
4.	Inxhinieri Matematike, Profili Analiza Sistemesh	Master Profesional
5.	Inxhinieri Matematike, Profili Aktuaristikë	Master Profesional
6.	Inxhinieri Fizike	Master Shkencor
7.	Inxhinieri Matematike	Master Shkencor
8.	Inxhinieri Fizike në Mjekësi	Master Shkencor
9.	Inxhinieri Matematike	Doktoraturë (PHD)
10.	Inxhinieri Fizike	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:** Rr. "Muhamet Gjollesha", mbrapa shkollës "Vasil Shanto", Tiranë

Për më shumë informacione <https://fimif.edu.al/dim/>

Zyra e Karrierës: [rozinamehmetaj@yahoo.com](mailto:rozinamehmetaj@yahoo.com)




Figura 2.2 - Vendndodhja e FIMIF

#### 4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave (FGJM)



## Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave (FGJM)




### Pak histori

Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave është shkolla e parë e lartë në Shqipëri për përgatitjen e specialisteve për të gjitha degët e shkencave të indusritsë minerare.

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave u formua dhe u zhvillua në kuadrin e Institutit të Lartë Politeknik të Tiranës dhe Fakultetit të Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës. Mbi këtë bazë, drejtimi i përgatitjes së studentëve ka qënë dhënia e titullit “Inxhinier” për të gjitha specialitetet që përgatiteshin. Kjo lidhet me formimin e thellë inxhinierik të planeve dhe të programeve mësimore. Ky drejtim vazhdon të jetë edhe sot.

### Struktura e brendshme organizative

Dekan FGJM	<b>Prof. Vasil Jorgji</b>
Zv.Dekan Zv.Dekan	<b>Prof. Irakli Prifti</b> <b>Dr. Altin Karriqi</b>



<b>Nr.</b>	<b>Programi i studimit</b>	<b>Lloji i diplomës</b>
<b>1.</b>	Inxhinieri Ggeomjedisi	Bachelor
<b>2.</b>	Inxhinieri Gjeoinformatike	Bachelor
<b>3.</b>	Inxhinieri e Burimeve Minerare	Bachelor
<b>4.</b>	Inxhinieri e Naftës dhe Gazit	Bachelor
<b>5.</b>	Inxhinieri Gjeologjike	Bachelor
<b>6.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji	Master Shkencor
<b>7.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, Profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme dhe Petrologji	Master Shkencor
<b>8.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure	Master Shkencor
<b>9.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeoinformatikë	Master Shkencor
<b>10.</b>	Inxhinieri Burimet Minerare, profili Pasurim Mineralesh dhe Riciklim Mbetjesh	Master Shkencor
<b>11.</b>	Inxhinieri Burimet Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi	Master Shkencor
<b>12.</b>	Inxhinieria e Naftës dhe Gazit	Master Shkencor
<b>13.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji	Master Shkencor
<b>14.</b>	Inxhinieri Ggeomjedisi	Master Shkencor
<b>15.</b>	Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare	Master Profesional
<b>16.</b>	Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Gjeomatikë	Master Profesional
<b>17.</b>	Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Pasurim i Mineraleve dhe Riciklim i Mbetjeve	Master Profesional
<b>18.</b>	Inxhinieri e Naftës dhe Gazit	Master Profesional
<b>19.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeoinformatikë	Master Profesional
<b>20.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji	Master Profesional
<b>21.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Gjeologji e vendburimeve të Hidrokarbureve	Master Profesional
<b>22.</b>	Inxhinieri Gjeologjike, profili Vendburimet e Mineraleve të dobishme-Petrologji	Master Profesional
<b>23.</b>	Inxhinieri Ggeomjedisi	Master Profesional
<b>24.</b>	Gjeoshkencat	Doktoraturë (PHD)
<b>25.</b>	Burimet dhe Mjedis	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:** Rr.Elbasanit, Tiranë, pranë kodrave të Liqenit Artificial. Për më shumë informacione: <https://www.facebook.com/gjeologjiku.fgjm/>

Zyra e Karrierës: [dea.shanto@live.com](mailto:dea.shanto@live.com)



Fig: 2.3 Vendndodhja e FGJM

## 5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)



## Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit




### Pak histori

Historia e Degës së Inxhinierisë Elektronike fillon që prej viteve '60, me formimin e Katedrës së Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë. Krijimi i Fakulteti të Teknologjisë së Informacionit daton në 2007. Programet e studimit të FTI-së ofrojnë njohuri në fushat e arkitekturës e sistemeve të telekomunikacioneve, teknikave numerike dhe analoge të përpunimit dhe transmetimit të sinjaleve multimediale, sistemet satelitore, sistemet me fibra optike, protokollet e transmetimit të dhënavës, rrjetat e kompjuterave, rrjetat me sensorë, rrjetat ad-hoc, arkitekturën e sistemeve të përpunimit, strukturën e bazave të dhënavës, sistemet e shpërndarë, inxhinieria e softuerit, teknologjitë Web, elementët bazë të sistemeve elektronike, projektimin e elementëve përbërës të sistemeve elektronike, aplikimet e sistemeve elektronike në industri, etj.

### Struktura e brendshme organizative

Dekan FTI	<b>Prof. Elinda Kajo (Meçë)</b>
Zv. Dekan	<b>Prof. Asoc. Indrit Enesi</b>
Zv. Dekan	<b>Dr. Evis Trandafili</b>

### Departamentet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit



Nr.	Programi I Studimit	Lloji I Diplomës
1.	Inxhinieri Elektronike	Bachelor
2.	Inxhinieri Informatike	Bachelor
3.	Inxhinieri Telekomunikacioni	Bachelor
4.	Inxhinieri Elektronike	Master Shkencor
5.	Inxhinieri Informatike	Master Shkencor
6.	Inxhinieri Telekomunikacioni	Master Shkencor
7.	Inxhinieri Informatike	Master Profesional
8.	Teknologji Informacioni	Master Profesional
9.	Teknologjite e Informacionit dhe Komunikimit:	Doktoraturë (PHD)
10.	Inxhinieri Informatike	Doktoraturë (PHD)
11.	Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:** Bul. “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, godina e re pas Korpusit Qendror.

Për më shumë informacione viziton: <http://www.fti.edu.al/>

## 1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)



## Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)

### Pak histori

1951 Themelohet Instituti Politeknik në Tiranë në të cilin bënte pjesë edhe Fakulteti Elektroteknik.


1953 Filloi sistemi pa shkëputje nga puna për përgatitjen e inxhinierëve elektrikë.

1983 Fakulteti i Inxhinierisë ndahet në dy fakultete: Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike (FIME) dhe në atë të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN).

2008 Me propozim të MASH dhe VKM ish-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE) (1991-2007) ndahet në dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.  
Zyra e Karrierës: [dolakonomi19@gmail.com](mailto:dolakonomi19@gmail.com)

### Struktura e brendshme organizative

Dekan FIE	<b>Prof. Asoc. Astrit Bardhi</b>
Zv. Dekan	<b>Dr. Marjola Puka</b>
Zv. Dekan	<b>Prof. Asoc. Myrteza Braneshi</b>



Nr.	Progami i Studimit	Lloji i Diplomës
1.	Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie	Bachelor
2.	Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitetikë	Bachelor
3.	Inxhinieri Mekatronike	Bachelor
4.	Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitetikë	Master Shkencor
5.	Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie	Master Shkencor
6.	Inxhinieri Elektrike, Profili Elektroenergjitetikë	Master Profesional
7.	Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie	Master Profesional
8.	Inxhinieri Mekatronike	Master Profesional
9.	Inxhinieri Elektrike, Elektroenergjitetikë	Doktoraturë (PHD)
10.	Inxhinieri Elektrike, Automatizim Industrie	Doktoraturë (PHD)
11.	Inxhinieri Elektrike, Elektroteknikë	Doktoraturë (PHD)

**Adresa:** Bul. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", godina e Korpusit Qendoror


## Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)

### Pak Histori

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është e para shkollë e lartë në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve të lartë në fushat e mekanikës, metalurgjisë dhe materialeve dhe tekstil modës i cili daton që nga viti 1951. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike formësohet si njësi e pavarur e Universitetit Politeknik në vitin 1991.

### Struktura e brendshme organizative

<b>Dekan FIM</b>	<b>Prof. Genti Guxho</b>
<b>Zv. Dekan</b>	Prof. Asoc. Odhisea Koca
<b>Zv. Dekan</b>	Prof. Asoc. Altin Dorri



Nr.	Programi i Studimit	Lloji i Diplomës
1.	Inxhinieri Mekanike	Bachelor
2.	Inxhinieri Tekstile dhe Modë	Bachelor
3.	Inxhinieri Materiale	Bachelor
4.	Inxhinieri Ekonomike	Bachelor
5.	Inxhinieri Mekanike, Profili Konstruksione Makanike dhe Mjete Lëvizëse	Master Shkencor
6.	Inxhinieri Mekanike, Profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial	Master Shkencor
7.	Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë	Master Shkencor
8.	Inxhinieri Tekstile dhe Modë	Master Shkencor
9.	Inxhinieri Materiale, Profili Materiale	Master Shkencor
10.	Inxhinieri Menaxhim Energjie	Master Shkencor
11.	Inxhinieri Ekonomike	Master Shkencor
12.	Inxhinieri Materiale	Master Profesional
13.	Inxhinieri Mekanike, profili Energjitikë	Master Profesional

<b>14.</b>	Inxhinieri Transporti	Master Profesional
<b>15.</b>	Inxhinieri Mekanike	Doktoraturë (PHD)

Për më shumë informacione <http://fim.upt.rash.al/>

Zyra e Karrierës: [hamitijona@yahoo.com](mailto:hamitijona@yahoo.com)

**Adresa:** Bulevardi “ Dëshmorët e Kombit” Sheshi “Nënë Tereza”, godina e Korpusit Qendror.




Figura 2.4 - Vendndodhja e Universitetit Politeknik të Tiranës FIE & FIM

**7. Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit**



## Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit



### Pak histori

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit është një njësi kombëtare kërkimore shkencore që vepron nën ombrellën e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Shërbimet kryesore të IGJEUM-it janë:

- Studimi i fenomeneve gjeologjike si: fenomenet gjeofizike, gjeomekanike etj. si dhe krijimi mbi bazën e tyre i hartave gjeologjike dhe tematike;
- Studimi dhe vlerësimi i burimeve natyrore të vendit përsa i përket burimeve nëntokësore minerale, energjetike dhe atyre ujore.
- Realizimi i kërkimit shkencor në fushën e rreziqeve natyrore si dhe të atyre të krijuara nga aktiviteti i njeriut (rrëshqitje, erozion, përmbytje, ndotje e mjedisit, etj.);
- Studim i mikrozonimit në lidhje me vlerësimin e riskut sismik në shkallë lokale dhe kombëtare;
- Adoptimi i standardeve europiane në studimet sismike.
- Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetit sismik të vendit dhe mundësimi i shpërndarjes së të dhënavët në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjere

### Struktura e brendshme organizative

<b>Drejtor IGJEUM</b>	<b>Prof. Asoc. Ylber Muceku</b>
-----------------------	---------------------------------

#### Departamentet e IGJEUM



**Adresa:** Rruga Don Bosko, Tiranë

## **Disa informacione të nevojshme**

Referur Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 33, sesionet e provimeve janë të përcaktuara dhe janë 3 (tre) në të dyja ciklet e studimit Bachelor dhe Master

Sesioni i Dimrit

Sesioni i Verës

Sesioni i Vjeshtës

Sesionet e provimeve zhvillohen pas 14 javësh mësim.

Në çdo vit mësimor të ciklit Bachelor zhvillohen lëndë, tërësia e të cilave përmban 60 kredite. Kreditet e nevojshme për të kaluar në vit ë dytë janë 30, ndërsa kalimi në vit të tretë kërkon 80 kredite nga të dy vitet paraardhëse pa detyrim përqindja që zë viti i parë apo i dytë.

Pasi studenti të ketë shlyer të gjitha detyrimet (provime + dorëzime detyrash) ka të drejtë të hyjë në provimin ose temën për mbrojtjen e diplomës.

Studenti, pas mbarimit të sesionit të verës, ka të drejtë të kërkojë në Sekretarinë mësimore të hedhë 2 lëndë të vitit që sapo ka përfunduar për përmirësim. (Të përserisë 2 provime të vitit që sapo përfundoi me qëllim përmirësimin e notës).



## Disa këshilla për ju!



## Si të menaxhojmë kohën e studimit gjatë sezonit të provimeve

### Përgatit një kalendar pune/studimi!

Mbaj parasysh datat e provimeve dhe sa nevojë ke për të mësuar apo përsëritur çdo lëndë. Ndaje materialin në detyra javore ose ditore sipas ditëve që ke në dispozicion.

### Kupto nëse truri juaj përthith më shumë informacion në mëngjes apo mbasdite/në darkë!

Nëse truri juaj përthith më shumë në mëngjes sigurohuni që gjatë kësaj periudhe të ditës të mësoni tema që i konsideroni të veshtira dhe gjatë mbasdites mund te përsërisni ose të studioni një material të thjeshtë.

### Vendos prioritetë!

Nise gjithmonë me detyrat më të rëndësishme.


### Pusho dhe relakso trurin!

Mund të jetë një pushim 10 minuta pas 1 ore studim. Pini ujë, hani një frut, dëgjoni 2-3 këngë.

### Ji fleksibël!

Jo gjithmonë planet shkojnë siç ne dëshirojmë. Kur bëni kalendarin e punës lini 1-2 ditë për përsëritje të përgjithshme/ teza të viteve të kaluara në mënyrë që të keni gjithmonë diçka rezervë.





## Teknika e sirtareve dhe koshit të letrave.

### Faza 1:

a) Ndajeni ditën tuaj në periudha gjysmëorarshe (psh: 07:00-07:30, 07:30-08:00 ...)

b) Shënoni në letër se me çfarë aktivitetesh do të merreni në këto periudha, që nga momenti që zgjoheni deri në momentin që shtriheni për të fjetur.

c) Përcaktoni listën e aktiviteteve kryesore që do të kryeni gjatë ditës. (Kini parasysh që t'i gruponit aktivitetet që kryeni në kohë të ndryshme të ditës duke u bazuar nga ngjashmëria e tyre. Ka disa aktivitete që janë rutinë e përditshme psh: vaktet e ngrënies apo kafja).



d) Tani ndajeni ditën në 3 pjesë:



1. Nga zgjimi (mëngjes) deri në orën 12:00 (mesditë)
2. Ora 12:00 (mesditë) deri ne 18:00 (pasdite)
3. Ora 18:00 (pasdite) deri sa të shkoni për të fjetur



e) Mbi bazën e listës së llojeve të aktiviteteve, përcaktoni sa orë keni harxhuar për çdo lloj aktiviteti në secilën prej pjesëve të ditës.

f) Mblidhni orët që keni harxhuar për çdo lloj aktiviteti në tri pjesët e ditës.

Në këtë mënyrë do të mësoni se sa orë harxhonit gjithsej duke u marrë me aktivitetet të dobishëm gjatë ditës suaj. Do të habiteni se sa kohë shpërdoroni duke ndenjur apo duke u ankuar.

**Faza 2:** Përcaktoni se cilat janë synimet tuaja afatgjata:

- Synimet që dëshironi të realizoni në fund të jetës suaj
- Synimet që dëshironi të realizoni për një periudhë 5-vjeçare
- Synimet që dëshironi të realizoni në një periudhë 6-mujore



Nga tërësia e synimeve tuaja afatgjata zgjidhni synimin më urgjent për ju. Përqendrohuni në synimin tuaj urgjent dhe përcaktoni konkretisht se çfarë duhet të bëni që ta realizoni.

Faza 3: Përcaktoni se cilat janë aktivitetet tuaja prioritare për këtë javë dhe për sot (të cilat ndihmojnë në realizimin e synimit tuaj afatgjat më urgjent).



Klasifikoni aktivitetet tuaja duke përdorur teknikën e “Tre sirtaret dhe koshi i letrave”.

**SIRTARI I SIPËRM:** Vendosni aktivitetet më të rëndësishme që do të bëni këtë javë dhe sot.

**SIRTARI I MESIT:** Vendosni aktivitetet që do të dëshironit të bënit këtë javë e sot, por që edhe mund të lihen mënjanë.

**SIRTARI I POSHTËM:** Në këtë sirtar vendosni ato aktivitete të cilat mund t'i kryeni vetëm nëse përfundoni aktivitetet e përfshira në sirtarin e sipërm dhe të mesit.



**KOSHI I LETRAVE:** Këtu vendosni aktivitetet kohëhumbëse ose kohëvrasëse (psh: Vërdallisja, shfletimi i revistave, story në Instagram, video në TikTok e Snapchat etj.).



**Faza 4:** Bëni një planifikim ditor të aktiviteteve tuaja në mënyrën që ju duket më e mira.

Për të bërë këtë, rikthehuni tek Faza 1. Shihni llojin e aktiviteteve dhe sasinë e orëve që i keni kushtuar atyre dhe pyesni veten:

- A janë këto aktivitete ato që duhen për të realizuar synimin afatgjat?
- A duhet të harxhoj më shumë apo më pak kohë për secilin aktivitet?



Pas kësaj mund të jetë e nevojshme të bëhen ndryshime në llojet e aktiviteteve dhe sasinë është kohës që i kushtonit atyre.

Mundohuni të keni parasysh:

- Përdorni teknikën e “Tre sirtare dhe koshi i letrave”.
- Planifikoni kryerjen e aktivitetit në kohën më të përshtatshme për to.
- Gruponi gjatë planifikimit aktivitetet që mund t'i kryeni në një vend apo në një kohë.

- Planifikoni që me parë gjëra të cilat mund t'ia delegoni të tjera. (nuk mund të bëni gjithçka vetë).
- Lini kohë rezervë mes kryerjes së aktiviteteve (asnjeherë nuk i dihet të papriturave).
- Planifikoni shpërblime për veten pas kryerjes së çdo aktiviteti.
- Lini kohë për të pushuar dhe për t'u kujdesur për veten tuaj.



# KAPITULLI 3

## Platformat Online



Gjatë periudhës së pandemisë si të gjithë, edhe Universiteti ynë u përshtat me mënyrën e zhvillimit të mësimit Online.

Si fillim u përdorën platforma të ndryshme si:

⇒ Classroom

Google Classroom  
Blended learning platform



⇒ Zoom

⇒ Google Meet

⇒ Microsoft Teams

Zoom Video Communications  
Company responsible for the Zoom software



Google Meet  
Video-conferencing software  
developed by Google



Aktualisht përdoret një platformë e unifikuar në të gjithë fakultetet, platforma Microsoft Teams.

Në momentin e regjistrimit në universitet, si student i tij, ti pajisesh me një e-mail në versionin [emër.mbiemër@\(...\).edu.al](mailto:emër.mbiemër@(...).edu.al)\*

\*janë inicialet e emrit të fakultetit psh. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit = fin


## Pak më shumë për Microsoft Teams



- ✓ Sipas klasave të ndara nga sekretaria mësimore secili pedagog formon klasat e leksioneve dhe seminareve sipas lëndëve përkatëse.
- ✓ Në secilën klasë studenti ka aksesin të përdorë materialet e hedhura nga pedagogu në sektionin “Files”
- ✓ Ka mundësinë e krijimit të një grapi “team” të pavarur nga stafi pedagogjik dhe të hapjes së një video konference me numër të palimituar pjesëmarrësish dhe pa limit kohëzgjatjeje.
- ✓ Ka mundësinë e kontaktit privat me çdo përdorues tjetër të këtij aplikacioni.
- ✓ Ky aplikacion është i aksesueshëm në PC, laptop, iPad, smartphone.


## Hapat që duhen ndjekur për të shkarkuar aplikacionin Teams

Në browser hapim adresën [www.office365.com](https://www.office365.com)




1. Logohemi me account-in e-mail të hapur nga universiteti.


[emër.mbiemër@fti.edu.al](mailto:emër.mbiemër@fti.edu.al)




## 2. Ndryshojmë Password e e-mail sipas udhëzimeve të aplikacionit



## 3. Futemi në Teams duke klikuar në ikonën e saj.



4. Mund të shkarkojmë aplikacionin në PC, laptop, iPad, smartphone nëse dëshirojmë



# KAPITULLI 4

## TARIFAT



Në ndihmë të studentëve, në këtë kapitull, kemi menduar të ndalemi në një përbledhje të tarifave të studimit për Universitetin Politeknik të Tiranës dhe çdo fakultet, duke përfshirë ciklin e studimeve Bachelor.

Ndarjet dhe tabelat përkatëse do t'i gjeni në vazhdim, (sqarojmë se këto tarifa janë për vitin aktual akademik dhe ato janë të ndryshueshme në bazë të vendimeve që merren nga institucionet përkatëse).

➤ Tarifat në UPT

**Tarifat e regjistrimit për programet në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2021 - 2022**

Nr	Programi i studimit	Tarifa/lekë
1	Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve	<b>1600</b>
2	Tarifa e regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve	<b>2500</b>
3	Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit	<b>3000</b>
4	Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve	<b>3000</b>
5	Tarifa e regjistrimit për kandidatët nga trojet shqiptare	<b>2000</b>

Tabela 7.1 Tarifat e regjistrimit UPT

**Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor**

**Tarifat e Shkollimit në programet e studimeve të ciklit te parë Bachelor për vitin akademik 2021-2022 :**

Nr.	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa, programi i parë për 60 Kredite /1 vit	Tarifa, programi i dytë për 60 Kredite / 1 vit
1.	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Inxhinieri Ggeomjedis	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Gjeoinformatikë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri e Gjeoburimeve	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Gjeologjike	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
2.	Fakulteti Inxhinierisë Mekanike	Inxhinieri Mekanike	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Tekstil dhe Modë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Materiale	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Ekonomike	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
3.	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Inxhinieri Matematike	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Fizike	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
4.	Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit	Inxhinieri Ndërtimi	<b>35,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Hidroteknikë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Mjedisi	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Gjeodezi	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
5.	Fakulteti Teknologjisë Informacionit	Inxhinieri Elektronike	<b>30,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Telekomunikacioni	<b>30,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Informatike	<b>30,000</b>	<b>203,690</b>

6.	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizimi i Industrisë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Elektrike, Profili Energjetikë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
		Inxhinieri Mekatronikë	<b>25,000</b>	<b>203,690</b>
7.	Fakulteti Arkitekturë Urbanistikë	Arkitekturë Interieri dhe Dizajn	<b>40,000</b>	<b>203,690</b>

Tabela 7.2 – Tarifat e shkollimit cikli i studimeve Bachelor, UPT

**3.Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë "MASTER Profesional"**

Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë "MASTER Profesional ", për vitin akademik 2021-2022:

Nr.	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për Kredit program i parë	Tarifa për Kredit program i dytë
1.	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Gjeomatikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi I Mbetjeve	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri e Naftes dhe e Gazit	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeoinformatikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologji Inxhinierike-Hidrogjeologji	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>

		Inxhinieri Gjeologjike, Profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologjia e Vendurimeve Hidrokarbure	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Ggeomjedis	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
2.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Transport	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Energjitikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Konstruksione	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Tekstili dhe Modë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Materiale	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
3.	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemesh	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Fizike	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Matematike, Profili Aktuaristikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
4.	Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimit	Inxhinieri Ndërtimi	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Hidroteknikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Mjedisi	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Gjeodezi	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
5.	Fakulteti i Teknologjisë Informacionit	Teknologji Informacioni	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Informatike	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
6.	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Elektroenergjetikë	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
		Inxhinieri Mekatronike	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>

7.	Fakulteti i Arkitekturës e Urbanistikës	Restaurim Monumentesh Kulture	<b>1,100</b>	<b>1,430</b>
----	---	-------------------------------	--------------	--------------

Tabela 7.3 – Tarifat e shkollimit cikli i studimeve Master Profesional UPT

**4. Tarifat e shkollimit në programet e studimeve të ciklit të dytë “MASTER Shkencor “, për vitin akademik 2021-2022:**

Nr	Fakulteti	Programi i Studimit	Tarifa për Kredit Program i parë	Tarifa për Kredit Program i dytë
1	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Inxhinieri e Naftës dhe e Gazit	<b>1,300</b>	<b>1,690</b>
		Inxhinieri Gjeomjedis	<b>1,300</b>	<b>1,690</b>
		Inxhinieri Gjeofizike	<b>1,300</b>	<b>1,690</b>
2	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Inxhinieri Mekanike, Profili Konstruksione dhe Mjete Lëvizëse	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
		Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitetikë	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
		Menaxhim Energjie	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
		Inxhinieri Mekanike, Profili Prodhim - Menaxhim Industrial	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>

		Inxhinieri Tekstili dhe Modë	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
		Inxhinieri Materiale	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
		Inxhinieri Ekonomike	<b>1,400</b>	<b>1,560</b>
3	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Inxhinieri Fizike, Profili Fizikan Mjekësor	<b>1,400</b>	<b>1,820</b>
		Inxhinieri Fizike, Profili Inxhinier Fizike	<b>1,400</b>	<b>1,820</b>
		Inxhinieri Matematike	<b>1,400</b>	<b>1,820</b>
		Inxhinieri Ndërtimi,Profili Ndërtim dhe Administrim	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Ndërtimi,Profili Strukturist	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
4	Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimit	Inxhinieri Ndërtimi,Profili Infrastrukturë Transporti	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Ndërtimi ,Profili Gjeoteknik	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Hidroteknikë	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Mjedis, Profili Trajtim Uji	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Mjedis, Profili Energjitetikë	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Gjeodezi	<b>1,750</b>	<b>2,275</b>
		Inxhinieri Elektronike	<b>1,700</b>	<b>2,210</b>
		Inxhinieri Telekomunikacioni	<b>1,700</b>	<b>2,210</b>
5	Fakulteti i Teknologjisë Informacionit	Inxhinieri Informatike	<b>1,700</b>	<b>2,040</b>
		Inxhinieri Elektrike,Profili Energjitetikë	<b>1,500</b>	<b>1,950</b>
6				

	Fakulteti Inxhinierisë Elektrike	i Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizimi i Industrisë	<b>1,500</b>	<b>1,950</b>
7	Fakulteti Arkitekturës dhe Urbanistikës	Arkitekturë, Profili Arkitekt	<b>40,000</b>	<b>203,690</b>
		Arkitekturë, Profili Urbanist	<b>40,000</b>	<b>203,690</b>

Tabela 7.4 – Tarifa e shkollimit cikli i studimeve Master Shkencor, UPT

Duhet të dini se sipas VKM në fuqi:

- Çdo student që ndjek ciklin e parë të studimeve, me mesatare 6-9 përfiton reduktim të tarifës me 50%.
- Çdo student që ndjek ciklin e parë të studimeve, me mesatare 9-10 nuk paguan tarifë dhe pëfiton bursë studentore 10,000 lekë në muaj.
- Çdo student që ndjek ciklin e dytë të studimeve, me mesatare 9-10 përfiton reduktim të tarifës me 50%.

## Bursat



Jeta e studentit është mjaft dinamike. Si e tillë, të papriturat me të cilat studentët përballen mund të kërkojnë, ndër të tjera, edhe një buxhet të konsoliduar nga pikëpamja financiare. Qiraja e shtëpisë, fatura e ujit dhe e energjisë elektrike, fatura e internetit, librat dhe fletoret, por edhe shumë shpenzime të tjera janë terma të dëgjuara për studentët. Ndonjëherë është e vështirë që të gjitha këto shpenzime të mbulohen nga buxheti "minimalist" i një studenti. Teksa një pjesë e studentëve e gjejnë zgjidhjen te punësimi për të siguruar mbulimin e shpenzimeve të muajit, ka edhe studentë që përdorin forma alternative për shkak të statusit që gëzojnë apo arritjeve mësimore që kanë. Po flasim për bursat, të cilat iu ofrohen studentëve të kategorive të ndryshme për të përballuar një pjesë të shpenzimeve të tyre. Bursat për studentët shqiptarë aktualisht ndahen në dy kategori: bursa për studentë të konsideruar si ekselentë dhe bursa për studentë të kategorive sociale.

Studentët të konsideruar si ekselentë janë ata të cilët e kanë mesataren e vitit paraardhës 9-10. Pra nëse një student është në vit të dytë në Bachelor dhe ka mesataren e vitit të parë 9.5 atëherë ai përfiton bursë ekselence. Për vitin e tretë, si referencë për mesataren do të merret vetëm viti i dytë, ndërsa për studentët e vitit të parë përdoret mesatarja e gjimnazit (duke përfshirë edhe provimet e maturës). Niveli i bursës për këtë kategori është 10,000 lekë në muaj dhe ofrohet vetëm për muajt e vitit akademik, pra duke mos përfshirë muajt e pushimeve verore.

Kategoria tjetër përfshin studentë që i përkasin kategorive të ndryshme sociale si: studentët, familja e të cilëve përfiton ndihmë ekonomike, studentët të cilët i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton, studentët që kanë përfituar statusin e jetimit deri në moshën 25 vjeç, bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare etj. Edhe në këtë rast niveli i bursës është 10. 000 lekë në muaj dhe ofrohet vetëm për muajt e përfshirë në vitin akademik.

Për më tepër, për këtë kategori studentësh, referojuni tabelës së mëposhtme e cila jep informacion për kategorinë ku studenti mund të bëjë pjesë si dhe dokumentat që duhet të dorëzojë për të qenë përfitues i bursës.

### **\*\* KUJDES!!!**

Kategoritë përfituese ose dokumentacioni i nevojshëm mund të ndryshojë sipas VKM-ve përkatëse. Informacione më zgjeruara dhe të përditësuara mund t'i gjeni në zyrën e financës pranë fakultetit tuaj.

Pika	Kategoria	Dokumentacioni i nevojshëm i studentit
i)	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihme ekonomike	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike
ii)	Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;	Certifikatë familjare, kopje id, Vërtetim studenti nga institucionet publike IAL
iii)	Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;	Kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës nga DRSHS, Kopje e vendimit të K.M.C.A.P
iv)	Studentët të cilët kanë të paktin njërin prind me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës nga DRSHS, Kopje e vendimit të K.M.C.A.P për prindin.
v)	Studentët që i kanë të dy prindërit pensioniste ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetim i pagesës së pensionit nga DRSHS,
vi)	Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, Vërtetimi që të dy fëmijët e parë janë studentë në IAL Publike.
vii)	Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	Kopje kartë indentiteti, vërtetim të statusit të jetimit.
viii)	Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;	Certifikate familjare, kopje kartë indentiteti, vendim gjykatë të formës së prerë
ix)	Studentët që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;	Kopje id, Vërtetim nga Ministria e Brendshme.
x)	Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrotjtës nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.	Kopje kartë indentiteti, Shkresa nga Ministria përkatëse.
xi)	Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit	Kopje kartë indentiteti, Formulari i vetëdeklarimit
xii)	Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.”	Certifikatë familjare, kopje kartë indentiteti, vërtetimi nga instituti i të përndjekurve politikë.

# KAPITULLI 5

TË DREJTAT E MIA



Shumë e rëndësishme për secilin prej nesh është të dimë dhe të kemi njohuri për të drejtat dhe detyrat që na përkasin si student ndaj në këtë kapitull jemi fokusuar pikërisht në këtë tematikë. Më poshtë do të gjeni të përbledhura dhe të listuara nenet e parashikuara për të drejtat dhe detyrat e marra nga Ligji për Arsimin e Lartë.

## Nga Statuti i UPT

### **1. Studentët e UPT kanë të drejtë:**

- a) Të përfaqësohen në organet kolegiale të UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë statut.
- b) Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në kornizën ligjore në fuqi si dhe shpërblime të veçanta, që administrohen nga UPT dhe miratohen nga BAUPT.
- c) Të shprehin opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punë e personelit akademik të UPT.
- d) Të ndjekin leksione, seminare/ushtrime dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore-shkencore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre.
- e) Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera, që UPT ofron për studentët.
- f) Të organizohen për çështjet e tyre në nivel institucional, njësie kryesore apo njësie bazë.
- g) Të pajisen për çdo vit akademik me Kartën e Studentit, që është dokument unik, me anë të të cilit, ata përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- h) Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit, përcaktohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- i) Kategoritë e shërbimeve, që ofrojnë entet shtetërore, publike dhe private, përcaktohen nga korniza ligjore në fuqi.



## **2. Studentët e UPT kanë për detyrë:**

- a) të zbatojnë rregullat e pëcaktuara në rregulloren e UPT, si edhe të njësive kryesore dhe bazë të tij, ku ata kryejnë studimet;
- b) t'u kushtojnë vëmendje studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
- c) të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron UPT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- d) të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në rregulloren e UPT;
- e) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjera.

➤ Studentët e UPT janë përgjegjës për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e këtyre detyrimeve.

## **Neni 100**

### Karta e studentit

1. Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në transport publik, muze, teatro, galeri, cinema, biblioteka, rrjete kafenesh, qendra tregtare etj.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.
3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njësive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.

4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

### **Neni 72**

Programet e studimit me karakter profesional

1. Institucionet e arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht “Certifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer.

2. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

### **Neni 73**

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

2. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloren e tyre pragun e notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.

3. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

**Neni 74**

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Institucionet e arsimit të lartë mund të vendosin edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen nga institucioni i arsimit të lartë dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.
3. Në fillim të vitit akademik, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar.

**Neni 75**

Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Të gjitha kriteret dhe modalitetet e fitimit të diplomave “Master i arteve” janë të njëjta me ato për fitimin e diplomës “Master i shkencave”, me ndryshimin që diploma “Master i arteve” lëshohet nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë formime në fushën e arteve.
3. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:
  - a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
  - b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të

studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

4. Programet e studimit “Master i arteve” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, në fushën e arteve. Këto programe realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike.

5. Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

6. Programet e studimeve “Master profesional” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Studimet e ciklit të dytë “Master profesional” përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” në fushën e arsimimit të kryer.

## **Neni 76**

Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë.

2. Pranimi në programet e integruara të studimeve është i mundur për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të këtij ligji.

3. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësia bazë ofruese e programit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull programet e integruara të studimit. Kriteret bëhen publike nga njësia kryesore dhe QSHA-ja dhe miratohen sipas përcaktimeve në statutin e IAL-së.

4. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

5. Institucionet e arsimit të lartë mund të njohin kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”.

6. Në fillim të vitit akademik, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë në QSHA listën e studentëve të regjistruar.

# KAPITULLI 6

## QYTETI I STUDENTËVE



Ndërsa sensi i kohës humbet  
nën shoqërinë e miqve, ne  
prekim çastet e lumtura.

Në këtë kapitull do të ndalemi në rezidencat studentore si alternativë e akomodimit të studentëve. Së pari do të njihem me kushtet dhe informacionet e përgjithshme për këtë formë strehimi dhe më pas do ndalemi në secilën prej rezidencave.

## Rezidencat studentore

Rezidencat shtetërore studentore në Tiranë kanë një kriter pranimi në bazë të universitetit që studenti ndjek.

Rezidenca studentore universitare nr.1 (Qytet Studenti) ka si përparësi të regjistrojë studentë nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Filologjik, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Universiteti i Arteve.

Rezidenca studentore universitare nr.2 pranë Inxhinierisë së Ndërtimit ka përparësi të regjistrojë studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, Universiteti i Sporteve, Fakulteti i Shkencave Sociale.

Rezidenca studentore universitare nr.3 pranë Universitetit të Mjekësisë ka si përparësi të regjistrojë studentë nga Universiteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.



**VËMENDJE!!!** Nëse në këto rezidenca ka vende vakante pas një date të caktuar (që afishohet nga institucioni përkatës) mund të bëjë regjistrimin çdo student edhe nëse nuk është në listën e përparësisë së rezidencave.

### Dokumentacioni i nevojshëm:

Mandati i pagesës tek BKT, Credins Bank ose Tirana Bank (për vitet e para)  
– Fotografi (4copë)

- Fotokopje e ID-së
- Vërtetim nga Universiteti
- Raporti Mjeko-Ligjor

## ➤ Rezidencia Studentore Universitare nr.1

Adresa: Rruga Arben Broci, Qyteti Studenti, Tiranë

### **Rezidencat me pagesë vjetore (45.000 Lekë)**

- Dhoma me 1 shtrat, dhoma me 2 shtretër, dhoma me 3 shtretër
- Tualete të përbashkëta
- Dushe të përbashkëta
- Energjia Elektrike + uji i pijshëm (i përfshirë në pagesë)
- Shërbimi i lavanderisë është me pagesë shtesë. Mandati tërhiqet pranë arkës në Drejtorinë e Rezidencës Studentore me vlerën 130 Lekë.



### **Stafi i punës:**

- Administratori Rezidencës
- Recepzioni (24orë)
- Punonjëset e Higjenës (të cilat kujdesen për mirëmbajtjen dhe higjenën e dusheve),
- Sanitaret

### **Përjashtim bëjnë disa nga rezidencat të cilat kanë pagesë si më poshtë:**

Rezidencia nr.6 me pagesë vjetore (50.000 Lekë)

Rezidencat nr. 11-12 me pagesë vjetore (55.000 Lekë)

## **Rezidencat 1 dhe 13 të cilat janë me pagesë mujore (pagesa 10.000 lek në muaj)**

**+ 5.000 lekë siguracion (nëse studenti nuk dëmton bazën materiale siguracioni kthehet në momentin e ndërprerjes së kontratës)**

- Dhomë me 2 shtretër + tualet + kabinë dashi
- Energjia elektrike + uji i pijshëm (i përfshirë në pagesë)
- Shërbimi i lavanterisë është me pagesë shtesë. Mandati tërhiqet pranë arkës në Drejtorinë e Rezidencës Studentore me vlerën 130 lekë.

### **Stafi i punës:**

Administratori i Rezidencës

Recepzioni (24 orë)

Sanitaret

### **Procedura e aplikimit për vërtetim:**

Kërkesa dorëzohet pranë Administratorit të Rezidencës me të dhënat e kërkuar:

- Fotokopje të ID-së
- Gjeneralitete
- Fakulteti
- Dega e studimit dhe viti
- Nr. e Rezidencës/dhomës

*Vërtetimi tërhiqet një ditë pas aplikimit pranë arkës në Drejtorinë e Rezidencës Studentore me vlerën 100 lekë.*

## ➤ Rezidencia Studentore Universitare nr 2

Adresa: Rruga "Artan Lenja", ish-Fusha e Aviacionit,  
pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit

- Rezidencia me pagesë vjetore (63 000 lekë)
- + 2000 lekë siguracion për mirëmbajtjen e ambientit  
të cilat rikthehen në zgjidhjen e kontratës.



Janë funksionale 3 godinat A-B-C

Secila prej tyre me kushte të njëjta ofrojnë:

- Dhoma me 2 shretër, dhoma me 3 shtretër
- Tualete dhe dushe për vetëm 5 persona
- Energjia elektrike + uji (24 orë) të përfshira në pagesë.



## Rezidencia Studentore Universitare nr. 3

Adresa: Rruga e Dibrës 265, Tiranë

## Të drejtat dhe detyrat e studentëve në Rezidencën Studentore Universitare (RSU)

### Të drejtat e studentëve:

Studenti i akomoduar në RSU e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në Drejtorinë e Shërbimeve Studentore.

Studentët kanë të drejtë:

- Të pajisen me kartën e studentit;
- Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e shërbimit dhe punën e personelit të RSU-së;
- Të përdorin bibliotekat dhe mjetet sportive, kulturore e informative të RSU-së;
- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në këshillat e studentëve;
- Të zgjedhin përfaqësinë studentore nga të cilat përftohet Këshilli i Përfaqësisë Studentore të Rezidencës;
- Kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të përfitojnë bursë studimi dhe shpërblime e çmime të veçanta për merita studimi e kërkimi shkencor që administrohen nga universiteti;
- Të organizohen në shoqata studentore jopolitike duke ju përmbajtur përcaktimëve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;



### Detyrat e studentëve:

- Të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga ky Statut, Rregullorja e universitetit, rregulloret e brendshme të fakulteteve, si dhe çdo akt ligjor apo nënligjor për arsimin e lartë;
- Të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet dhe programet mësimore;
- Të paguajë tarifën e shkollimit dhe të shërbimeve që ofron universiteti;
- Të respektojë kodin e etikës të miratuar nga Këshilli i Etikës;
- Të respektojë të drejtat e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor, dhe administrativ si dhe të studentëve të tjera;
- Mosrespektimi nga ana e studentit, i detyrimeve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloren e fakulteteve, ndëshkohet me masa disiplinore të përcaktuara në rregullore;

# KAPITULLI 6

## TË GJEJMË RRUGËT



Cdo rrugë tē con drejt **Suksesit**,  
E rēndēsishme ēshtë tē zgjedhesh  
atē qē respekton **Vlerat e tua**

Në këtë kapitull do të ndalemi në njohuritë e nevojshme përsa i përket shërbimit të transportit publik. Këtu gjeni informacionet kryesore mbi linjat e transportit urban të qytetit dhe ndërqytetas duke përfshirë itinerarin e linjave përkatëse, oraret dhe vendndodhjet e terminaleve.

**- Njohuritë më kryesore do t'i gjeni të listuara në vazhdim:**

- I. BILETA E TRANSPORTIT URBAN TË QYTETIT KUSHTON: 40 LEKË.
- II. ABONEJA E STUDENTIT KUSHTON: 600 LEKË
- III. ABONEJA E PERGJITHSHME KUSHTON: 1600 LEKË

Më poshtë do të ndalemi në shërbimin e transportit urban:

**- Linjat kryesore të transportit urban qytetas:**

1. "Selitë-Kristal-Qendër-Stacioni i Trenit-Allias"
2. "Qyteti Studenti-Jordan Misja"
3. "Teg-Sauk i Vjetër-Kopshti Zoologjik-Ish Stacioni i Trenit"
4. /A "Marteniteti i Ri- Qendër-Ish Fusha e Aviacionit" dhe Linja /B "Qendër-Mihal Grameno-Qendër"
5. "Kashar-Yzberisht-Qendër"
6. "Porcelan"
7. "Qendër-QTU-Megatek-City Park"
8. /A "Uzina Dinamo e Re-Sharrë" dhe /B "5 Maji-Sharrë"
9. /A "Ish Kombinati i Autotraktorëve-Institut" dhe Linja /B "Institut-Ish Kombinati i Autotraktorëve"
10. "Tirana e Re"
11. "Laprakë"
12. "Unaza"
13. "Tufina"
14. "Kombinat-Kinostudio".
15. "Ish Stacioni i Trenit-Qendër-Sauk i Ri/ Sauk i Vjetër/ Sanatorium-Teg"

## 1.Tirana e Re



Figura 5.1 – Autobusi i linjës “Tirana e re”




Figura 5.2 – Linja e transportit urban “ Tirana e re”

## 2.Unaza



Figura 5.3 – Autobusi i linjës "Unaza"




Figura 5.4 – Linja e transportit publik “Unaza”

### 3.Qendër –Sauk



Figura 5.5- Autobusi i linjës “Qendër –Sauk”




Figura 5.6 – Linja e transportit publik “ Qendër - Sauk”

#### 4.Kombinat-Kinostudio



Figura 5.7 – Autobusi i linjës “Kombinat – Kinostudio”




Figura 5.8 - Linja e transportit publik “Kombinat - Kinostudio”

## 5.Tufinë




Figura 5.9 - Linja e transportit publik “Tufinë”

Në vazhdim do të njiheni me sistemin e transportit ndërqytetas, duke u ndalur në informacionet specifike për terminalin ndërqytetas zona Jug, zona Jug-Lindje dhe zona Veri. Në këtë paragraf do të përfshihet informacioni mbi vendndodhjen e terminaleve, linjat dhe oraret e çdo udhëtimi.

#### **- Sistemi i Transportit Ndërqytetas:**

- **Terminali i Autobusëve Ndërqytetas Zona Jug**

Adresa: Terminali i Autobusëve Ndërqytetas nr.1, ZONA JUG dhe Durrës. Adresa: (te mbikalimi i Kamzës, pranë "Casa Italia")

#### **Linjat Ndërqytetase në Terminal janë:**

Nr	Qyteti	Orari
1	Ballsh	06:15, 7:45, 12:00; 13:00, 14:00, 15:00, 16:00
2	Memaliaj	7:15, 8:15, 14:00, 15:00, 16:45, 17:45
3	Tepelenë	07:00; 11:00; 13:00; 14:00
4	Poliçan	07:05; 10:35; 12:15; 14:00
5	Sukth	06:20, 07:00, 07:30, 08:00, 08:30, 09:30, 10:30, 11:30, 12:30, 13:00, 14:00, 15:30, 16:30, 18:30, 20:30
6	Shijak	07:00; 10:00; 11:00; 12:00; 12:45, 13:30, 14:15; 15:00; 15:45, 16:30; 17:15, 18:00
7	Roskovec	12:15, 14:15, 15:15
8	Përmet	05:30; 06:30; 07:30; 8:15, 09:00; 11:30; 12:30; 14:00; 15:30; 17:30;
9	Sarandë (Bregdeti)	06:15; 21:00

<b>10</b>	Sarandë	05:30; 07:30; 08:30; 09:45; 12:30; 14:15; 16:00, 22:00
11	Himarë	05:30; 07:30; 08:30; 12:30, 13:00, 18:00
<b>12</b>	Fratar	14:30, 16:00
13	Orikum	10:00
<b>14</b>	Kavajë	07:00; 08:30; 10:00; 12:00; 13:30, 14:00 15:00; 17:00
<b>15</b>	Peqin	06:45, 13:00
<b>16</b>	Divjakë	06:00, 07:00, 08:00; 09:00, 10:00, 11:30, 13:10, 14:45
<b>17</b>	Manëz	09:00; 11:00; 13:00; 15:00
<b>18</b>	Delvinë	07:30; 10:30; 13:00; 14:50
<b>19</b>	Rogozhinë	06:30; 07:30; 08:30, 09:30; 10:30; 12:00, 13:00, 14:00; 15:00, 17:00
<b>20</b>	Libohovë	05:45; 13:00
<b>21</b>	Patos	04:45, 07:45, 10:40, 11:00, 11:40, 12:40, 13:40, 14:00, 14:40, 15:40
<b>22</b>	Kuçovë	06:45; 09:00; 10:45, 14:30
<b>23</b>	Fier	05:00, 05:30, 05:55, 06:20, 06:45, 07:10, 07:35, 08:00, 08:25, 08:50, 09:15, 09:40, 10:05, 10:30, 11:00, 11:30, 12:00, 12:30, 13:00, 13:30, 14:00, 14:30, 15:00, 15:30, 16:00, 16:30, 17:00, 17:30, 18:00, 18:30, 19:00, 19:30
<b>24</b>	Gjirokastër	05:00; 06:45, 08:00; 09:00; 10:00, 11:00, 12:00, 13:00, 14:30, 15:30, 17:30, 18:30, 20:30
<b>25</b>	Lushnjë	05:40, 06:10, 06:40, 07:10, 07:40, 08:10, 08:40, 09:10, 09:40, 10:10, 10:45, 11:30, 12:00, 12:30, 13:00, 13:30, 14:00, 14:45, 15:30, 16:15

26	Berat	05:40; 06:30; 07:15; 07:45; 08:15; 08:50; 09:20; 09:50; 10:20; 11:00; 11:30, 12:00; 12:30; 13:00; 13:30; 14:00; 14:30; 15:00; 15:30; 16:00; 16:30, 17:00, 17:30
27	Vlorë	05:00, 05:30, 05:55, 06:20, 06:45, 07:10, 07:35, 08:00, 08:25, 08:50, 09:15, 09:40, 10:05, 10:30, 11:00, 11:30, 12:00, 12:30, 13:00, 13:30, 14:00, 14:30, 15:00, 15:30, 16:00, 16:30, 17:00, 17:30
28	Durrës	06:00, 06:30, 07:00, 07:30, 08:00, 08:30, 08:45, 09:00, 09:20, 09:40, 10:10, 10:30, 10:50, 11:10, 11:30, 11:50, 12:10, 12:30, 13:00, 13:30, 14:00, 14:30, 15:00, 15:15, 15:30, 16:00, 16:20, 16:40, 17:00, 17:20, 17:40, 18:00, 18:30, 19:00, 19:30, 19:45, 20:00, 20:30, 21:00, 21:15
29	Skrapar	06:00; 11:10; 13:00, 14:30, 16:10

Tabela 5.1 Linjat dhe oraret e transportit ndërqytetas, zona Jug

- **Terminal i Autobusëve Ndërqytetas Zona Veri**

Nr	Qyteti	Orari
1	Kukës	06:00-19:00 (çdo një orë)
2	Bulqizë	6:00; 7:00; 8:00; 9:00; 10:00; 11:00, 12:30; 13:30; 14:30; 16:00, 17:00
3	Shkodër	05:00, 06:00, 06:30, 07:00; 07:30, 8:00; 08:30, 9:00; 09:30, 10:00; 10:30, 11:00; 11:35; 12:00, 12:30; 13:00; 13:30, 14:00; 14:30; 15:00, 15:30; 16:00; 16:30, 17:00, 17:30, 18:00
4	Mirditë	6:15; 7:30; 9:00; 10:00; 11:00; 12:00; 13:00; 14:00; 15:30; 17:00
5	Pukë	5:00; 6:00; 7:00; 10:00; 11:00, 11:45, 13:00; 14:00; 16:00

<b>6</b>	Burrel	06:00, 7:00; 8:00; 9:00; 10:00; 11:00; 12:00; 13:00; 14:00; 15:00; 16:00; 17:00
<b>7</b>	Dibër	6:00; 8:00; 10:00; 11:00; 13:00; 14:00; 16:00; 17:00
<b>8</b>	Krujë	07:00, 08:00, 09:00, 10:00; 11:00; 12:00, 13:30; 14:00; 15:00, 17:00; 18:00
<b>9</b>	B.Curri (Qafa e Malit)	08:00, 10:00, 10:30, 11:00
<b>10</b>	B.Curri (Koman)	05:00, 10:30
<b>11</b>	B.Curri (Kosova)	05:30, 06:00, 07:00, 08:00, 09:00, 10:00, 11:00, 12:00, 14:00, 14:30, 15:30
<b>12</b>	Has	12:30; 13:30; 14:30; 15:30; 16:30
<b>13</b>	F. Arrëz	05:00; 05:30, 06:00, 07:40, 8:10; 12:00; 14:00
<b>14</b>	F. Krujë	05:00-18:00 (çdo 30 min)
<b>15</b>	Klos	05:30, 08:00; 12:00, 14:00
<b>16</b>	V.Dejës	07:00, 10:00, 17:00
<b>17</b>	Koplik	06:30; 07:15, 12:00, 13:00
<b>18</b>	Laç	05:30-19:00 (çdo 30 min)
<b>19</b>	Lezhë	06:00, 06:20, 07:00, 08:00, 09:00, 10:00, 11:00, 12:00, 12:30, 13:00, 14:00, 15:00, 16:00, 17:00, 18:00, 19:00
<b>20</b>	Rrëshen	06:00, 07:30, 09:00, 10:30, 11:00, 12:00, 13:00, 14:00, 15:00, 16:00, 17:00, 18:00

Tabela 5.3 – Linja dhe oraret e transportit ndërqytetas, zona Veri




Figura 5.10 – Vendndodhja e Terminalit të autobusëve ndërqytetas, zona Jug dhe Veri

- Terminal i Autobusëve Ndërqytetas Zona Jug-Lindje**

Adresa: Terminali i Autobusëve Ndërqytetas Nr.2, i cili ndodhet pranë hyrjes së qytetit të Studentit, rruga “Arben Broci”, Tiranë.

Terminali i Autobusëve Ndërqytetas 2 përbën këto linja:

Nr	Qyteti	Oraret
1	Elbasan	05:45 19:45 (çdo një orë)
		06:00-21:30(çdo 30min)
	Belsh	13:00
	Cërrik	13:00
	Gramsh	07:00, 09:00

		13:00, 15:00
<b>2</b>	Librazhd	12:15, 14:00, 16:00
<b>3</b>	Përrenjas	13:00, 14:00
<b>4</b>	Pogradec	12:30, 13:30, 14:30, 15:30 06:30, 08:30, 09:30
		11:45, 12:30, 13:15, 14:00, 14:45, 15:30, 16:15, 17:00
	Korçë	05:45, 06:30, 07:15, 08:00, 08:45, 09:30, 10:15, 11:00
		10:00, 14:30
	Ersekë	06:00
<b>5</b>	Leskovik	13:00
		06:30, 07:00
<b>6</b>	Bilisht	11:30, 14:30

Tabela 5.2 – Linja dhe oraret e transportit ndërqtetas, zona Jug-Lindje




Figura 5.11 – Vendndodhja e Terminalit të autobusëve, zona Jug-Lindje

# KAPITULLI 8

## KONTAKTE TË RËNDËSISHME



Në jetën e përditshme secili nga ne mund të përballet me probleme dhe ngjarje të papritura, ndaj në këtë kapitull jemi ndalur në grupimin e disa kontakteve të rëndësishme.

Në vazhdim do të gjeni këto informacione:

### **Qendra Spitalore Universitare Tiranë**

**Telefono:** 00355 4 2349233

### **Urgjencia (për Tiranën)**

**Telefono:** 00355 4 2222235

**Adresa:** Rr. Dibrës, Nr. 372, Tiranë

### **Rezervimet e Konsultave Ambulatore**

**Telefono:** 0800 28 28 (vetëm nga numër fiks)

00355 4 2349217



## Covid-19

Ne e dimë tashmë që Covid-19 është kthyer në pandemi në vendin tonë që nga viti 2020, prandaj është e rëndësishme të marrim masa për të mbrojtur veten dhe të tjeterët. Veprimet e mëposhtme do t'ju ndihmojnë në mospërhapjen e COVID-19:

- Shmangni kontaktin e afërt me personat e sëmurë.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës.
- Qëndroni në shtëpi nëse jeni sëmurë.
- Mbuloni gojën dhe hundën nëse kolliteni dhe teshtini me një pecetë letre, të cilën më pas duhet ta hidhni.
- Pastroni dhe dezinfektoni rregullisht objektet dhe sipërfaqjet duke përdorur detergjentët e zakonshëm të shtëpisë.
- Lani duart shpesh me ujë dhe sapun.



## Terminologjia e përdorur:

UPT - Universiteti Politeknik i Tiranës

FIM - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

FIE - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

FIN - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

FTI - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

FGJM - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

FIMIF - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

FAU - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

IGJEUM - Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit

## Bibliografia:

Faqja zyrtare e Universitetit Politeknik të Tiranës / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Inxhinierisë së Gjeologji-Minierave / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit / web

Faqja zyrtare e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës / web

Faqja zyrtare e Bashkisë së Tiranës / web

Ligji për Arsimin e Lartë

Statuti UPT

Broshura informative e UPT

Broshura informative e rezidencave studentore shtetërore RSU

“Psikologjia e Stresit” Theodhori Karaj

# Përbledhje

Në këtë Guidë studentore u ndalëm fillimi i shkurtër për të njohur qytetin e Tiranës, për të kaluar më pas në disa njohuri të domosdoshme lidhur me jetën studentore duke përfshirë këtu njohuri mbi universitetin dhe fakultetet përkatëse, pak historik, listën e programeve, vendndodhjen dhe formën e organizimit të tyre.

Më tej, në mënyrë të përbledhur u ndalëm në të drejtat dhe detyrat e studentëve, bazuar në nenet e parashikuara në ligjin për Arsimin e Lartë.

Ndër problematikat apo çështjet që një student mund të përballet nuk mund të mungonin informacionet bazë përsa i përket strehimit dhe akomodimit në rezidencat studentore, duke përfshirë informacione për procesin e regjistrimit, vendndodhjen e rezidencave, tarifat vjetore, kushtet e tyre, por dhe të drejtat dhe detyrat e studentëve si banorë në këto rezidencia.

Pa diskutim, që në çdo rast, është e nevojshme lëvizja dhe udhëtimi, brenda qytetit të Tiranës apo jashtë tij. Në këtë prizëm, informacioni mbi transportin publik u konsiderua si i nevojshëm për studentët, duke pasqyruar detaje mbi linjat kryesore, itinerarin dhe orarin e tyre.

Jeta studentore në fakt është e shpejtë, plot dinamizëm dhe të papritura. Shumë herë disa kontakte të rëndësishme mund të janë zgjidhje e problematikave të përditshme dhe për këtë arsyë në një kapitull të veçantë janë të grupuara pikërisht kontaktet si: urgenca, policia etj.

Për të mbyllur këtë guidë të shkurtër, kapitulli i fundit përbën të listuara të gjithë tarifat e shkollimit për Universitetin Politeknik të Tiranës dhe çdo fakultet të tij, duke sqaruar këtu se këto tarifa janë për vitin aktual të studimit dhe ato janë të ndryshueshme në bazë të vendimeve nga institucionet përkatëse.

Duke shpresuar që kjo guidë të jetë një ndihmesë për secilin nga ju dhe një herë ju urojmë suksese në këtë vit të ri akademik!

# Falënderime

Guida studentore është një prodhim i iniciuar nga një grup studentësh, pjesë e *Universitetit Politeknik të Tiranës* në bashkëpunim me *Universitetin Politeknik të Tiranës*.

Një falenderim i veçantë shkon për ndihmën e pakushtëzuar të Rektoratit dhe specifikisht Zyrës së Karrierës, që mundësuan mbështetjen dhe kontaktet me të gjithë drejtoret e nevojshme deri në financimin dhe realizimin e këtij projekti.

Urojmë që për secilin nga ju, kjo guidë të jetë një udhërrëfyes dhe ndihmesë në jetën e përditshme studentore.

Pa diskutim vlerësim dhe mirënjoyje shkon për vullnetin, punën e palodhur, dëshirën dhe kohën e kushtuar nga studentët e grupit të punës në finalizimin e këtij projekti duke botuar Guidën studentore:

Altena Qyrku	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Aurela Kalthi	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Andri Çepi	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Artenisa Kërçyku	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Burhan Misiraj	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit
Erjon Doçi	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Fatime Selimaj	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
Fioresilda Hatellari	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
Ilda Lekgëgaj	Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit
Izmir Xhafa	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
Klaudja Bezati	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Valbona Halitaj	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

*Ne do të jemi pranë jush përgjatë gjithë rrugëtimit tuaj universitar!*